

**June 6, 1964**

**Minutes of the meeting between the Democratic Republic of Vietnam's delegate Tran Dinh Thu with an Albanian official Shpresa Fuga on June 6, 1964**

**Citation:**

"Minutes of the meeting between the Democratic Republic of Vietnam's delegate Tran Dinh Thu with an Albanian official Shpresa Fuga on June 6, 1964", June 6, 1964, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1964, D 256, p. 10  
<https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110202>

**Summary:**

This document is a report on a meeting between the Democratic Republic of Vietnam's delegate, Tran Dinh Thu, with an Albanian official, Shpresa Fuga. Tran Dinh Thu reveals his appreciation for Albanian political support towards the cause of the South Vietnamese people against the United States. Tran Dinh Thu is also upset about the lack of actual financial support from the Soviet Union by comparing it to the more commendable support of the United States government for the government of South Vietnam. He asks for further Albanian support for the South Vietnamese people and asks that awareness of the Vietnam conflict be spread among the Albanian population.

**Original Language:**

Albanian

**Contents:**

Original Scan

Vietnam 1964 10

DEKLASIFIKUAR

8. III / 4 (B/I-3)

MPJ ARKIVI Viti: Dosja: Fleta:

Information

MPJ ARKIVI  
osja  
File  
2/61  
Mbi takimin me te ngarkuarin me pune te RD te Vietnamit shokun Tran Dinh Thuj:

Me daten 5 qershor prita ne takim te ngarkuarin me pune te RD te Vietnamit shokun Tran Dinh Thuj me kerkesen e tij. Takimi ishte ne vijim te takimit te tije me shokun Ulvi Lulo lidhur me gjendjen ne Vietnamin e Jugut, per te cilen tha shume shkurt se si amerikanet duan ta kthejne ate ne nji vater agresioni dhe se si RD e Vietnamit ka bere vazhdimisht propozime dhe proteste mbi kete qeshtje. Ay informoi mbi noten e Ministries se se P. te Jashtme te RD te Vietnamit drejtuar bashke-Kryetarëve te konferences se Gjeneves, dhe pjese mearesve ne te, date 26 maj 1964 mbi indokinen. Ne note tha ay ~~kerkesen~~ protestohet per gjendjen e krijuar ne Vietnamin Jugor, kerkohet largimi i trupave amerikane dhe ti ipet fund-gjendjes se krijuar atje. Tha se do te na dergojte me nji here kopje te notes se sapo e kish marre dhe u lut qe te mbeshteten nga ana e jone. Propozoi per ndonji proteste qeveritare dhe per protesta nga organizatat e masave.

I ngarkuari me pune falenderoi nxehtesisht per tere ndihmen edhene nga ana e jone ne drejtim te luftes se popullit te Vietnamit te Jugut. Ne, tha ay, nuk dime si te shprehim mirenjohjen dhe falenderimet tona per gjithcka keni bere dhe beni ne mbeshtetje te luftes sone. Shtypi dhe radjua kane folur dhe flasin shume per gjendjen e krijuar ne Vietnam, se ka nji mbeshtetje te forte nga ana e jone, se edhe gjate kohes se qendrimit ne Shqiperi te delegacionit te Vietnamit te Jugut eshte bere nji pune shume e madhe etj. Ay falenderoi per te gjitha keto dhe per pritjen dhe ndihmen e dhene delegacionit te Vietnamit te Jugut. Perfaqesite revizioniste, tha ay, duhet te kene kuptuar shume si nga pritja dhe trajtimi i juaj delegacionit ne fjale, ashtu edhe nga pershendetjet ne koktejn e dhene nga ambasada ku ishin edhe ata, ashtu edhe nga deklarata e kryetarit te delegacionit lidhur me ate qe ne vendet e tjera socialiste te evropes kane nji perkrahje nga lart vetem (DMTH



MPJ ARKIVI  
Viti: Dosjak: Fleta:  
1 DEKLASIFIKUAR

masave nuk u eshte bere e njohur lufta ne Vietnam).

Lidhur me te verteten mbi Vietnamin ose me ate qe revizionistet nuk ndihmojne ne fakt luften e popullit vietnamez, i ngarkuari me pune me thaxx se: "Juve u a themi hapur si shoke qe, Hrushovi vetem flet mbi luften ne Vietnamin Jugor dhe kete per te treguar se e ndihmon ndersa ne fakt nuk na ndihmon. Gjate dhjete vjeteve, Bashkimi Sovjetik e ka ndihmuar luften me vetem 300.000 rubla ndersa shtetet e Bashkuara i japin qeverise kuckell te Vietnamit Jugor 1.500.000 dollare ne dite". Keto qeshtje tha ay, ju vune mire ne dukje delegacionit te partise komuniste te Bashkimit sovjetik nga shoku Eezhuan."

Duke theksuar marredhenijet me vendin tone dhe ndihmen tone, ay tha se eshte porositur nga udheheqja e taje qe te bisedoje me ne gjithcka dhe te kerkoje ndihmen tone, per te cilen shoket e tije i kane thene se tek ne do te gjejne pa tjetër mbeshtetje. Ne tha ay jemi plotesisht dakord me ju ne te gjitha qeshtjet, per taktike delegacioni i Frontit te V.J. mbajti ate qendrim, na kuptoni, ne hapem perfaqesine ne Tirane mbas pleniumit te 9-te te K.Q., plenium i cili ishte kryesisht kunder revizionizmit modern.

2) Ngriti qeshtjen se kur ishte ketu delegacioni i Vietnamit te Jugut i la nji ekspozite frontit tone demokratik mbi masakrat ne Vietnamin Jugor. Tha se mos tani me rastin e protestave qe mund te behen nga ne, mos eshte oportune qe te hapet edhe kjo ekspozite.

3) I ngarkuari me pune deshiron te beje vizita ne organizatat e masave, ne ATSH; radjo etj, tu flase per gjendjen ne Vietnamin Jugor dhe tu jape edhe materjale dhe nuk din ne se eshte e mundeshme nji gje e tille.

4) U lut qe ta njoftojme ditën e kthimit ne Shqiperi te delegacionit tone te grave.

I thashe se ne kemi ~~parkkrahur~~ mbeshtetur dhe do te mbeshtesia kurdohere luften e drejte qe ben populli i Vietnamit te Jugut kunder imperializmit amerikan, se qeshtja e tyre eshte e drejte etj. ne frymen e qendrimit qe mbajme ne mbi kete qeshtje. Aprovova qendrimin negativ te revizionisteve kundrejt



VII  
105j04 F. a

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI  
Viti:  
Dosja: Fleta:

luftes ne Vietnamin Jugor dhe kunder imperializmit ne pergji-  
thesi etj. I thashe se mund te vije ne Ministrine e P. te Jasht  
teme sa here qe te doje dhe se ne do ta ndihmojme etj. Se do ti  
njoftojme ditën e kthimit ne atdhe te delegacionit te grave.  
Lidhur me ekspoziten i thashe se nuk isha ne dijeni dhe se do  
tja referoja kete çeshtje frontit demokratik dhe se per vizitat  
ne org. e masave etj do te vija ne dijeni protokollin.

Lidhur me te gjitha keto propozoj:

1) Perveç mbeshtetjes zyrtare qe eshte duke u pregatitur;  
shtypi i yne te vazhdoje ta trajtoje kete problem me informata  
te ndryshme si edhe deri tani. Mbi kete te shkruajne artikuj  
ne forme proteste edhe organet e tjera dhe te org. te masave  
si Bashkimi, Zeri i Rinise, Shqiptarja e Re, Puna etj. ne menyre  
qe te mos behen protesta te veçanta mbasi ne shkurt te ketj vi-  
ti ne beme një fushate te tille.

2) Te hapet ne klubin e shkrimtareve ekspozita e lene nga  
delegacioni, por pa u zhvilluar ndonji ceremoni per inagurim.  
Mbi kete mund te shkruaje gazeta Bashkimi. Per kete çeshtje  
bisedova edhe me shoket e frontit. Ekspozita ka rreth 90 tablo.

3) Mund tu thuhet org. te masave qe ta presin te ngarkuarin  
me punete vietnamit dhe ti ipet edhe atij pergjigje per kete  
çeshtje.

Tirane me 6 qershor 1964.

Shpresa Fuça

*Shpresa Fuça*

*16 bisedova  
me shoket e klubit  
13/6/64*

*illegjti*

*dyqto*

*deklar*